



VENDIM

Nr. 18, Datë 24 /02/2017

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLOREVE DHE KRITEREVE TË KONKURSIT TË PRANIMIT PËR VITIN
AKADEMIK 2017-2018,
TË FAKULTETIT TË ARTEVE TË BUKURA NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Në zbatim të, Nenit 38-Funksionet e Senatit Akademik, e vijim - të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", shkresës Nr. 13 prot., datë 22/02/2017, të Fakultetit të Arteve të Bukura, Senati Akademik i UART, pasi diskutoi mbi "Rregulloret dhe Kriteret e konkursit të pranimit për vitin akademik 2017-2018, të Fakultetit të Arteve të Bukura, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë "Bachelor" dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve" relativuar nga Dekani i FAB, Prof. Asoc. Ardian Isufi,

VENDOSI

1. Miratimin e "Rregulloreve dhe Kriterëve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2017-2018, të Fakultetit të Arteve të Bukura, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë "Bachelor" dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve".
Bashkëlidhur, Rregullorja dhe kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të parë me kohë të plotë "Bachelor" si dhe Rregullorja dhe Kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve", të Fakultetit të Arteve të Bukura.
2. Ky Vendim, të publikohet në faqen zyrtare të UART.
3. Rregulloret dhe kriteret e konkursit të dërgohen zyrtarisht në MAS.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Milto KUTALI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Nansy GJERAZI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Rafael HOXHA

Udh. 200 Prot
22.02.2017



Nr. 13 prot.

Tiranë, më 22/02.2017

Drejtuar : Rektorit të UART

Per dijeni: Senatit të UART

ZV/ Rektorit te UART, Prof. Dr. Erald Bakalli

Lënda: Përcjellje e dokumentacioneve për konkurset e pranimit në Ciklin I dhe Ciklin II të Studimit në FAB për vitin akademik 2017-2018.

Bashkëngjitur do të gjeni Kriteret dhe Rregulloren për zhvillimin e konkursit të pranimit në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" dhe Ciklit II – Master në Arte në Fakultetin e Arteve të Bukura për vitin akademik 2017-2018.

DEKANI I FAB

Prof. Asc. Ardian ISUFI



UNIVERSITETI I ARTEVE



Tiranë, më ___/___/2017

R R E G U L L O R E

PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT
NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË
“BACHELOR”

NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA,
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE
PËR VITIN AKADEMIK 2017 – 2018

MIRATUAR ME VENDIM NR. 18, DATË 27.02.2014
TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 74, Pranimi në ciklin e parë të studimeve, si dhe mbështetur në Rregulloren e UART të ciklit të parë të studimeve "Bachelor", konkurset e pranimit në Fakultetin e Arteve të Bukura për vitin akademik 2017-2018 do të zhvillohen si më poshtë:

Neni 1

Pranimi i kandidatëve

- 1.1. Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Arteve të Bukura në Universitetin e Arteve, bëhet mbi rezultatin e konkurseve që zhvillohen pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit, sipas kësaj Rregulloreje, si dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve dhe pikëve totale të Maturës Shtetërore.
- 1.2. Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3. Përzgjedhja e konkurrentëve është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për të gjitha kategoritë.
- 1.4. Pikët maksimale të vlerësimit si dhe ndarjen e tyre në përqindje, kufiri minimal i pikëve të pranimit për çdo konkurrent do të zbatohet sipas Vendimit të Senatit Akademik.

Neni 2

Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 2.1. Dekani i Fakultetit, mbështetur në propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisionit të Pranimit.
- 2.2. Komisionet e pranimit ngrihen për secilën njësi bazë, sipas programeve të studimit.
- 2.3. Përbërja e anëtarëve të Komisionit të Pranimit shpallet në ditën e fundit të konkursit të punës praktike në atelier.
- 2.4. Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
 - I. Titullarë të fushës përkatëse,
 - II. Pedagogë me kohë të plotë të Departamenteve përkatëse,
 - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës, për ato programe studimi që nuk mbulohen nga pikat I dhe II të këtij neni.
- 2.5. Në përbërje të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë konflikt interesi me konkursin e pranimit.
- 2.6. Në mjediset ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Arteve të Bukura.
- 2.7. Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posatshëm, ngre grupin përkatës, që monitoron cilësinë e zhvillimit të gjithë procedurave të konkurimit në Fakultetin e Arteve të Bukura, si dhe nga përfaqësuesit e MAS.



Neni 3

Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurrimit.

- 3.1 Kanë të drejtë të rregjistrohen në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
- 3.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Arteve të Bukura.
- 3.3 Konkursi për Fakultetin e Arteve të Bukura do të zhvillohet në mjediset e Fakultetit, në zbatim të kësaj rregulloreje, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.
- 3.4 Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi si më poshtë:
 - I. *Kartë Identiteti / Pasaportë.*
 - II. *Vërtetimin e rregjistrimit të marrë nga sekretaria e fakultetit të Arteve të Bukura.*
 - III. *Mandatpagesën për pjesëmarrje në konkursin e pranimit, e depozituar në llogarinë e Universitetit të Arteve.*
(Kandidati që s'paraqet këto dokumente, nuk lejohet të marrë pjesë në konkurs).
- 3.5 Në varësi të specifikave komisioni do të punojë paradite dhe pasdite me paraqitjet individuale të kandidatëve, duke i bërë më parë të njohura oraret përkatëse. Njoftimet për oraret shpallen pranë Fakultetit të Arteve të Bukura.
- 3.6 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe mjediset e zhvillimit të tyre, do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve, pranë Fakultetit të Arteve të Bukura. Ky kalendar shpallet në Fakultet dhe Web-in e Universitetit të Arteve, një javë përpara fillimit të konkursit.
- 3.7 Në momentin e rregjistrimit, në formularin që plotëson pranë sekretarisë, konkurenti përzgjedh programet e studimit, sipas Njesisë Bazë (*Pikturë, Arte të Aplikuara, Skulpturë*). Ai ka mundësi konkurimi, vetëm për dy programe studimi të cilat i përkasin Njesisë Bazë të përzgjedhur.
- 3.8 Ditën e parë të konkursit, pasi të jenë sistemuar në atelierët përkatës, konkurentëve u komunikohen të gjitha rregullat e konkurrimit.
- 3.9 Sekretaria mësimore, vulos secilën fletë vizatimi ose telajo pikturë të konkurentëve pjesëmarrës, pasi konkurentët kanë filluar punë. Në përfundim të ditës së dytë çdo konkurent shkruan në punën e tij/e saj, në anën e djathtë, poshtë, emrin dhe mbiemrin. Sekretaria mësimore, në prani të konkurentit, mbi emrin e shkruar, vendos një zarf dhe e vulos atë.
- 3.10 Sekretaria mësimore i dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 3.11 Bazuar në kriteret për secilën Njësi Bazë dhe program studimi përkatës, komisioni krijon hapësirën kohore të nevojshme për prezantimin individual të kandidatëve gjatë konkurrimit.



Neni 4

Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 4.1 Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhet nga Komisioni i Pranimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga Titullari i Fakultetit.
- 4.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre) anëtarë.
- 4.3 Gjatë paraqitjes individuale të kandidatëve, anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu, çdo anëtar i jurisë, ka të drejtë t'i drejtojë kandidatin që konkurren pyetje konkrete, të cilat i duken të arsyeshme, për një njohje sa më të mirë të tij.
- 4.4 Mbas paraqitjes së kandidatit të fundit, në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurrimit, Komisioni i Pranimit, nën drejtimin e Kryetarit, mbledhet për të vlerësuar një për një paraqitjen e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 4.5 Pikët e mundshme në dispozicion të Komisionit të Pranimit, të miratuara nga Vendimi i Senatit Akademik, shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë anëtarët e komisionit. Secili anëtar vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 4.6 Kur kandidati nuk rezulton fitues në përzgjedhjen e parë, dhe rezultojnë kuota të paplotësuara në përzgjedhjen e tij të dytë, Komisioni rishikon mundësinë e shpalljes fitues në këtë program studimi.
- 4.7 Komisioni i Pranimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista rendore, me pikët e konkurrentëve me rend zbritës, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 4.8 Lista e nënshkruar e pjesëmarrësve në konkurset e pranimit, sipas formatit elektronik të dërguar nga AKP, si dhe shënimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit për secilin konkurrent, me të gjitha dosjet me materialet e mësipërme, i dorëzohen me procesverbal Dekanit të Fakultetit.

Neni 5

Shpallja e fituesve

- 5.1 Renditjen e listës së fituesve, sipas pikëve të marra nga Komisioni i Pranimit të konkursit, duke i bashkuar edhe pikët e maturës shtetërore, e bën sekretaria mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura.
- 5.2 Në rastin kur disa konkures kanë fituar të njëjtin shumë pikësh, ata nënrenditen midis tyre sipas rendit zbritës të pikëve të fituara në punën praktike të realizuar në atelie.
- 5.3 Lista përfundimtare me pikët me rend zbritës, duke vendosur vijën e kuqe, mbështetur në kuotat e miratuara nga MAS, e firmosur nga Dekani i Fakultetit, i përcillet Rektoratit.

Neni 6

Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 6.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.



Adresa: Biv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al

- 6.2 Kandidatët që rregjistrohen si studentë në Universitetin e Arteve, duhet të paraqesin **dokumente origjinale**. Ato duhet të jenë në vartësi të Udhëzimeve të MAS.
- 6.3 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet:
- I. Numri i rregjistrimit,
 - II. Emri i kandidatit
 - III. Data dhe ora e rregjistrimit.
- Fleta e rregjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 6.4 Në rregjistër çdo kandidat fitues duhet të nënshkruajë.
- 6.5 Kandidatit që çrregjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale, por jo pagesa e rregjistrimit.
- 6.6 Rregjistrimet e kandidatëve fitues, për të gjitha kuotat, kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Arteve të Bukura, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Neni 7

Rregulla për kandidatët

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 7.1 Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit, në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve, e shpallur në Fakultetin e Arteve të Bukura.
- 7.2 Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimi në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni.
- 7.3 Mosparaqitja në këtë orar çon në skualifikimin e tij nga konkursi.
- 7.4 Konkursi është kolektiv dhe individual.
- 7.5 Kandidati duhet të plotësojë para Komisionit kërkesat që rrjedhin nga kriteret për çdo Program Studimi.
- 7.6 Komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shprehë sa më mirë aftësitë e tij.
- 7.7 Kandidati do të largohet nga konkurrimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë, pasi ka ezauruar procesin e pyetjeve.

DEKANI
Prof. Asoc. Ardian Isufi





Nr. _____prot.

Tiranë, më _____2017

**KRITERET TEKNIKE SI DHE RUBRIKAT E KONKURSIT TË PRANIMIT NË
CIKLIN I-BACHELOR-FAKULTETIN E ARTEVE TE BUKURA
VITI AKADEMIK 2017-2018**

Konkursi për seleksionim dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj do të zhvillohet sipas kriterëve teknike të përcaktuara si më poshtë:

Konkursi do të mbështetet në tre rubrika kryesore për të arritur nivelin më të mirë të mundshëm të testimit të një kandidati brenda kohës së caktuar:

Rubrikat:

1. Punë Praktike në Atelie (pikturë, skulpturë, vizatim)

2. Testim teorik

3. Prezantim i dosjes personale

1. Punë Praktike në Atelie do të zhvillohet si më poshtë:

Kohëzgjatja : 2 ditë nga 5orë

Tema e veprës: Studim dhe interpretim nga natyra duke ju referuar figurës së njeriut (model nga natyra)

Dimensioni i veprës: 70 x 90 cm

Teknika e perdorur: Vizatim ose Pikturë (për kandidatë të Pikturës), Vizatim ose Skulpturë (për kandidatë të Skulpturës) .

Disa sqarime të mëtejshme të kriterëve të mësipërme.

Studimi nga Natyra do të propozohet dhe organizohet si më poshtë:



Në të gjitha atelietë e shkollës ku do të zhvillohet testimi praktik i kandidatëve për studentë do të ketë modele të vendosur (figurë njeriu).

Studentët do të prezantohen me modelet dhe më pas ata do të vendosin:

- a. Cilin model zgjedhin.
- b. Mënyren se si kompozojnë.
- c. Teknikën me të cilin realizojnë veprën.

Shënim: Në rastin konkret Modeli i propozuar (figurë njeriu) para kandidateve, shërben si shkak që ata, në mënyrë të ndërgjegjshme të ekspozojnë më qartë një qëndrim individual të shprehjes. Duke mos kushtezuar prerjen e Figurës sipas një kompozimi Standart, si dhe teknikën me të cilën do të realizohet vepra, studenti vihet në pozicion krijues, ku i jepet mundësia të interpretojë si nga pikepamja kompozicionale po ashtu edhe në drejtim të hulumtimit psikologjik, të zgjedhë mjetin dhe format e shprehjes nëpërmjet një raporti ndjesor më personal me figurën e propozuar.

Si kundër u tha me lart në Ditën e Parë të Konkurimit ata pasi të njihen me modelin do të vendosin teknikën me të cilën do të realizojnë veprën e tyre. Vepra do të jetë Një (1) : ose Vizatim, ose Pikturë, ose Skulpturë që do të realizohet në 2 ditë

Baza Materiale

Kandidatët për Studentë duhet të vijnë të përgatitur me këto materiale përkatëse:

Letër Vizatimi 70x90, (të bardhë)

Telajo Pikturë 70x90, si dhe të gjitha mjetet e tjera plotësuese për të realizuar një vepër në vizatim apo në telajo(pikturë).

Për Kandidatët Skulpturës, Fakulteti siguron materialin (baltë plastike, armature) në qoftë se ata zgjedhin modelimin, Plastikën për të realizuar punën e tyre.

2. Testimi Teorik I cili në vetevetë përmban tre faza të përshkuara si më poshte

Kohezgjatja: 2 dite + (në varësi të nr. të konkurentëve)

Fazat:

Faza e parë është Testimi i Kandidatit për Student në Lenden Histori Arti. Ky testim do të kryhet nëpërmjet përgjigjes direkte mbi Tezen e Zgjedhur. Teza është e fshehtë.

Literaturë së ciles do t'i referohet çdo kandidat për tu përgatitur:



- Të gjithë tekstet teorike apo materialet me të cilat kanë studiuar nxenesit në shkollat e mesme artistike apo te pergjithshme

- Historia e Artit (E.H. Gombrich)

- Aventurë e Artit në shek.XX dhe materiale të tjera alternative.

Faza e Dytë është Interviste e Kandidatit për Student me Anëtarët e Komisionit.

Qëllimi është: Për të testuar nivelin e përgjithshëm kulturor, ndjeshmëritë artistike, marrëdhënien e tij me një proces artistik që ai kryen, e lidhur kjo ngushte me formacionin e fakultetit, kerkesat tij si dhe ato cka ky fakultet kerkon prej studenteve dhe i ofron atyre njekohesisht.

Faza e Tretë është shqyrtimi i Dosjes Personale të Kandidatit për Student, në të cilën ai prezanton praktikisht një grup punesh te kryera prej tij kryesisht gjate dy viteve te fundit, dhe që ai mendon se bëjnë prezantimin më të mirë artistik të tij. Këto punë mund dhe duhet të plotësojnë imazhin e punës praktike që ai kryen në atelier në dy ditët e para të konkursit.

Dosje profesionale personale

1. Vizatime e skica të ndryshme, realizime me laps karbon etj. Realizime në vaj, tempera, akuarel etj. (për pikturën)
2. Realizime në skulpturë me foto si dhe punime në skulpturë etj.(për skulpturën)
3. Realizime në teknika të grafikës, tekstil, foto, video, punime në kompjuter etj.

Punimet në vizatim, pikturë dhe skulpturë janë të detyrueshme, ndërsa ato të pikës 3 mbeten fakultative, sipas dëshirës dhe preferencës së konkuresit. Numri i përgjithshëm i punimeve që duhet të përmbajë dosja të jetë jo më pak se 20.

Shënim:

Kandidati për student është përgjegjës për autorësinë e materialit që prezanton në dosjen e tij personale. N.q.s nga Komisioni verifikohet material i manipuluar, pra jo produkt i kandidatit, ndaj tij do të merret masa e largimit nga procesi i konkursit për këtë vit akademik.

Gjatë procedurës së regjistrimit, kandidati duhet të deklarojë detyrmisht me shkrim specialitetin që preferon të zgjedhë për të vazhduar studimet pranë këtij Fakulteti. (Lejohen deri në 2 (dy) preferenca të shprehura nga kandidati te rradhitura sipas preferencës së parë dhe të dytë).

DEKANI I FAB

Prof. Asc. Ardian ISUFI

UNIVERSITETI I ARTEVE



Tiranë, më ___ 2017

RREGULLORE

PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT

NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË

"MASTER I ARTEVE"

NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA,

NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

PËR VITIN AKADEMIK 2017 – 2018

MIRATUAR ME VENDIM NR 18 , DATË 27.02.2017

TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë, në Republikën e Shqipërisë", Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 76, Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, si dhe mbështetur në Rregulloren e UART të ciklit të dytë të studimeve "Master", konkurset e pranimit në Fakultetin e Arteve të Bukura për vitin akademik 2017-2018 do të zhvillohen si më poshtë:

Neni 1

Pranimi i kandidatëve

- 1.1 Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Arteve të Bukura në Universitetin e Arteve, bëhen mbi rezultatin e konkurseve që zhvillohen për studimet në ciklin e dytë të studimeve "Master", pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj rregulloreje si dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 1.2 Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta "Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja", do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3 Përzgjedhja e tyre është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, posaçërisht për trojet Shqiptare.

Neni 2

Kriteret e pranimit

- 2.1 Të kenë kryer programin e studimit të ciklit të parë Bachelor pranë këtij fakulteti ose nga Fakultete të tjera si brenda dhe jashtë vendit.
- 2.2 Pranohen të gjithë ato kandidatë që kanë kryer studimet në ciklin e vjetër 4-vjeçar në fakultetin e Arteve të Bukura. Gjithashtu edhe ato kandidatë të ciklit 4-vjeçar, të fakulteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- 2.3 Për konkurentët që kanë kryer studime jashtë vendit kërkohet njësimi i Diplomës sipas Ligjeve në fuqi.
- 2.4 Baza e konkurimit për kandidatët në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Arteve të Bukura për studime në ciklin e dytë të studimeve "Master", janë kriteret e miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 2.5 Kandidatët për programin e studimit "Master i Arteve", duhet të dorëzojnë pranë Fakultetit të Arteve të Bukura, dosjen personale të konkurentit ku të jenë të përfshira:

- I. CV e tij/e saj,
- II. Diplomën, (fotokopje e noterizuar)
- III. Listën e notave të programit të studimit të kryer, (fotokopje e noterizuar)
- IV. Dëshmi mbi rezultatet e arritura në procesin e realizimit të programit mësimor,



- V. Projekte,
- VI. Workshope,
- VII. Ekspozita, etj.

2.6 Dosja duhet të përmbajë dëshmitë e aktiviteteve artistike, si brenda dhe jashtë shkollës:

- I. Postera,
- II. Fletë palosje,
- III. Fotografi,
- IV. Dhe çdo material tjetër që dëshmon aktivitetet artistike të konkurrentit.

2.7 Kandidatët që kanë kryer programe të tjera studimi, jashtë Fakultetit të Arteve të Bukura, brenda dhe jashtë vendit do të bëjnë një intervistë bashkëbisedimi me komisionin e pranimit.

2.8 Për çdo sqarim tjetër në lidhje me konkursin, programet e studimit si dhe me plotësimin e krediteve, drejtohuni pranë Fakultetit të Arteve të Bukura.

Neni 3

Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 3.1** Dekani i Fakultetit, mbështetur nga propozimet e Përgjegjësve të Njërive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimit për çdo program e Studimi.
- 3.2** Përbërja e Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 3.3** Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
 - I. Titullarë të fushës përkatëse,
 - II. Pedagogë efektivë të Departamenteve përkatëse,
 - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi ku nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij Neni.
- 3.4** Në përbërjen të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit apo janë në konflikt interesi.
- 3.5** Në mjediset ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Arteve të Bukura .
- 3.6** Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posaçëm ngre grupin përkatës, i cili monitoron cilësinë e zhvillimit të gjithë procedurave të konkurimit në Fakultetin e Arteve të Bukura, si dhe nga përfaqësuesit e MAS.

Neni 4

Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurimit.



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al

- 4.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e Nenit 2, të kësaj rregulloreje.
- 4.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët që janë regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Arteve të Bukura, brenda afatit të përcaktuar nga MAS.
- 4.3 Konkursi për Fakultetin e Arteve të Bukura do të zhvillohet në mjediset e Fakultetit, sipas udhëzimeve të MAS.
- 4.4 Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi si më poshtë:
 - I. *Kartë Identiteti*,
 - II. *Pasaportë*
(Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs).
- 4.5 Kandidati konkurent për të hyrë në konkurs duhet të ketë bërë pagesën e përcaktuar, në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- 4.6 Në varësi të specifikave për secilin Program Studimi komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite me paraqitjet individuale të kandidatëve, duke i bërë të ditura më parë oraret përkatëse. Oraret duhet të shpallen në mjediset e Fakultetit të Arteve të Bukura
- 4.7 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe mjediset e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve pranë Fakultetit të Arteve të Bukura.
- 4.8 Kalendarin e Orareve dhe Mjedisëve shpallet në Fakultet një javë përpara fillimit të konkursit.
- 4.9 Ditën e parë të konkursit faza e II pasi të jenë sistemuar në ambientet e zhvillimit të tij, kandidatëve u komunikohen rregullat e konkurimit. Kjo bëhet nga Kryetarët e Komisioneve përkatëse.
- 4.10 Sekretaria mësimore ju dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 4.11 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet krijojnë hapësirën kohore të nevojshme për prezantimin individual të kandidatëve gjatë konkurimit.

Neni 5

Mënyra e Vlerësimit

- 5.1 Vlerësimi maksimal për çdo konkurrent është gjithsej **100 pikë**.
- 5.2 Vlerësimi maksimal i Fazës së parë të konkurimit mbi shqyrtimin e dosjes është **50 pikë**.
- 5.3 Vlerësimi maksimal i Fazës së dytë të konkurimit është **50 pikë**.



Neni 6

Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 6.1 Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhen nga Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga titullari i Fakultetit.
- 6.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).
- 6.3 Gjatë paraqitjes individuale të kandidatëve, anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu çdo anëtar i jurisë ka të drejtë t'i drejtojë kandidatin që konkuron kërkesa konkrete, të cilat i duken të arsyeshme për një shpërfaqje sa më të mirë të tij.
- 6.4 Mbas paraqitjes së kandidatit të fundit, në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurimit, Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, mblidhen për të vlerësuar një për një paraqitjet e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 6.5 100 pikët e mundshme në dispozicion të Komisionit të pranimit, shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë anëtarët e komisionit.
- 6.6 Secili anëtar i komisionit të pranimit vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 6.7 Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 6.8 Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit.
- 6.9 Komisionet e Programeve të Studimit në Fakultetin e Arteve të Bukura, me kërkesë të tyre, mund t'i kërkojnë Titullarit të Fakultetit, xhirimin e konkursit.
- 6.10 Komisionet e Pranimit të Programit të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet dhe kasetat me materialet e mësipërme ja dorëzojnë me procesverbal Titullarit të Fakultetit.
- 6.11 Lista përfundimtare me pikët respektive për të gjithë Programet e Studimit firmosen nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Neni 7

Shpallja e fituesve

- 7.1 Shpalljen përfundimtare të fituesve e bën Dekani i Fakultetit mbi bazën e kuotave të aprovuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit
- 7.2 Në rastin kur disa konkures kanë fituar të njëjtin numër pikësh, ata nënrenditen midis tyre sipas rendit zbritës të pikëve të fituara në testin special, (faza e dytë).

Neni 8

Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 8.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.



Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 247 597, www.uart.edu.al

- 8.2** Kandidatët që regjistrohen si student në Universitetin e Arteve duhet të paraqesin **dokumente origjinale**.
- 8.3** Ato duhet të jenë:
- I. Diploma Bachelor
 - II. Për kandidatët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dokumentet e mësipërme duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe e të notuara.
 - III. Kartë identiteti,
 - IV. Pasaportë,
 - V. 2 (dy) fotografi
 - VI. Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit që caktohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- 8.4** Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 8.5** Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç'regjistrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.
- 8.6** Kandidatit që ç'regjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 8.7** Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Arteve të Bukura, në datat që do të përcaktojnë Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Neni 7 **Rregulla për kandidatët**

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 9.1** Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve i shpallur në Fakultetin e Arteve të Bukura.
- 9.2** Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni i Programit të Studimit. Mosparaqitja në bazë të këtij orari çon në s'kualifikimin e tij nga konkursi.
- 9.3** Konkursi është kolektiv dhe individual.
- 9.4** Kandidati duhet të paraqesë para Komisionit kërkesat që rrjedhin nga kriteret e konkursit të pranimit për çdo Program Studimi.
- 9.5** Nga ana tjetër komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shpreh aftësitë e tij.
- 9.6** Kandidati do të largohet nga konkurimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë.

DEKANI
Prof. Asc. Ardian ISUFI



Nr. ____ prot.

Tiranë, më _____, 2017

KRITERET E KONKURISIT TË PRANIMIT NË CIKLIN II- MASTER NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA për vitin akademik 2017-2018

Në programet e studimit Master që ofrohen në Fakultetin e Arteve të Bukura pranohen kandidatët që plotësojnë kriteret e mëposhtme :

1. Të kenë kryer programin përkatës të studimit të ciklit të parë " Bachelor " pranë Fakultetit të Arteve të Bukura si dhe ata që kanë kryer programe të tjera të ciklit të parë Bachelor por dhe të ciklit 4 - vjeçar brenda këtij Fakulteti, me ose pa plotësim kreditesh.
2. Pranohen kandidatë që kanë kryer programe studimi nga Fakulteti i Artit Skenik, Programi Studimit Skenografi.
3. Pranohen, gjithashtu, kandidatë që kanë kryer programe studimi (të afërta me programet e studimit në FAB) jashtë Universitetit të Arteve, me plotësim kreditesh.
4. Në seleksionimin e kandidatëve do të kenë përparësi ata që në ciklin e parë kanë arritur mesataren e notave mbi 7 (shtatë).
5. Faza parë. Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Fakultetit të Arteve të Bukura një dosje që të përmbajë **CV e tij/ të saj dhe dëshmi mbi rezultatet e krijimtarisë gjatë programit të studimit të ciklit të parë : projekte personale, ekspozita etj. (nëse ka) si dhe një studim teorik jo më pak se 5 faqe (Dosja duhet të dorëzohet brenda datës / / 2017, ora_____)**. Për kandidatët që vijnë nga programe të tjera studimit, jashtë Fakultetit të Arteve të Bukura, në dosje duhet të përfshihen arritje dhe aktivitete në
6. programet përkatëse të studimit, përfshi gjithashtu aktiviteti artistik jashtë shkolle i dëshmuar me postera, fletë palosje, referenca etj.



7. Faza e dytë. Testimi teorik për të gjithë kandidatët të cilët kanë paraqitur Dosjen me përmbatjen e mësipërme dhe brenda afateve të caktuara

8. Kandidatët që kanë kryer programe të tjera studimi, jashtë Fakultetit të Arteve të Bukura, do t'i nënshtrohen një interviste më të zgjeruar me komisionin e ngritur për këtë qëllim pranë këtij fakulteti.

Për çdo sqarim tjetër në lidhje me konkursin, programet e studimit si dhe me plotësimin e krediteve, drejtohuni pranë sekretarisë mësimore Fakultetit të Arteve të Bukur, si dhe adresës elektronike të Universitetit të Arteve.



DEKANI

Prof. Asc. Ardian ISUFI

UNIVERSITETI I ARTEVE